



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

## RREGULLORE TEKNIKE

**“PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT DHE  
KLASIFIKIMIT TË MJETEVE RRUGORE TË HERSHME DHE ME  
KARAKTER HISTORIK”**



DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E SHËRBIMEVE TË  
TRANSPORTIT RRUGOR

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallati “Bjorn”  
Tiranë 1010, Shqipëri  
Tel.: +355 68 801 5 833; Fax.: +355 (0) 42238175  
e-mail: [dpshttr@dpshttr.gov.al](mailto:dpshttr@dpshttr.gov.al); [www.dpshttr.gov.al](http://www.dpshttr.gov.al)

## **Neni 1**

### *Hyrje*

Kjo Rregullore vjen në mbështetje të Nenit 60 të Kodit Rrugor dhe Nenit 211/a të Vendimit Nr.153, datë 07.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Direktivës 2014/45/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 03.04.2014.

## **Neni 2**

### *Qëllimi*

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurave të vlerësimit dhe klasifikimit të ciklomotorëve, motoçikletave dhe automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi, lëshimin e Certifikatës së Njohjes së këtyre mjeteve, mbajtjes së një regjistri elektronik kombëtar Retro, si dhe mënyrat e promovimit të kësaj kulture.

## **Neni 3**

### *Baza ligjore*

Në Pikën 13 të Preambulës, të Pikës 2 të Nenit 2 të Direktivës 2014/45/EU, parashikohet se mjetet rrugore të hershme që paraqesin interes historik (*Vehicles of historical interest*), konsiderohen ato mjete që ruajnë trashëgiminë e periudhës në të cilën janë prodhuar dhe që përdoren rrallë për qarkullimin e përditshëm.

Në Nenin 60 të Kodit Rrugor parashikohet se mjetet rrugore të hershme (*në vijim mjete Retro*) janë të përjashtuara nga përdorimi i zakonshëm dhe nuk mund të përdoren për qarkullim të përditshëm ose aktivitete ku mjete shfrytëzohet për biznes, në kuptimin e zakonshëm.

Në Nenin 211/a të VKM-së Nr.153, datë 07.04.2000, parashikohet se mjetet rrugore të hershme janë mjete që nuk përdoren në qarkullimin e përditshëm.

## **Neni 4**

### *Përkufizime*

Në kuptim të kuadrit ligjor dhe në zbatim të kësaj Rregulloreje, përkufizimet e mëposhtme janë:

*Mjet rrugor i hershëm* - në vijim të Rregullores do të ketë emërtimin “*mjet Retro*”. Mjeti merr këtë emërtim vetëm pasi ka kaluar fazën e shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimin teknik.

*Komisioni Retro* - Komision i përbërë nga pesë anëtarë, të cilët bëjnë verifikimin teknik të mjetit.

*Certifikatë Njohje* - dokument që lëshohet nga DPSHTRR, pasi mjeti fiton statusin e mjetit Retro.

*Viti i prodhimit* - viti në të cilin ka përfunduar procesi i prodhimit të një mjeti specifik. Data e përfundimit të fabrikimit mund të ndryshojë nga viti i prodhimit i shfaqur në dokumentet shoqëruese, të paraqitura nga prodhuesi për atë mjet. Kjo ndodh, për shembull, në rastet kur mjeti ka përfunduar së prodhuari në fund të vitit, por nga prodhuesi konsideron vitin pasardhës si vit të fillimit të atij modeli.

*Marka* - është emri tregtar i mjetit, emri i përdorur për identifikimin e mjetit në publik nga prodhuesi/konstruktori.

*Prodhuesi* - është personi fizik/juridik që ka ndërtuar mjetin.



*Modeli/Tipi/Seria* - janë të dhënat e përdorura nga prodhuesi në kohën e prodhimit, për të dalluar modelin nga të tjerët apo për të veçuar një linjë specifike të tij.

*Replica* – janë gjithë mjetet e prodhuara duke imituar me besnikëri një model të mirënjohur të së shkuarës. Këto mjete mund të jenë prodhuar duke u bazuar tek një ose disa mjete dhuruese, apo duke montuar pjesë të fabrikuara enkas për këtë model.

*Modifikime* - janë ndërhyrje apo shmangie që i janë bërë mjetit, që e ndryshojnë atë nga karakteristikat origjinale të fabrikimit, të bëra nga prodhuesi/konstruktori.

*FIVA* - Fédération Internationale des Véhicules Anciens (Federata Ndërkombëtare e Mjeteve Historike).

## **Neni 5**

### *Kriteret e pranimit*

Që të fitojë statusin Retro, një mjet rrugor duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Të jetë i prodhuar të paktën përpara 30 (tridhjetë) vitesh;
  - a) Për mjetet *Replica*, nuk do të shqyrtohet si kriter viti i prodhimit të modelit të imituar, por viti i montimit efektiv të mjetit;
  - b) Automjetet me sistem drejtimi në anën e djathtë do të merren gjithashtu në shqyrtim.
2. Të jetë i ruajtur apo i restauruar në formën e tij origjinale;
3. Të mos përdoret për qarkullim të përditshëm;
4. Të mos jetë më në prodhim.

Kriteret e mësipërme vlejnë për të gjithë modelet e automjeteve rrugore që qarkullojnë apo kanë qarkulluar në territorin e Republikës së Shqipërisë (me status aktiv, çregjistrim të përkohshëm apo çregjistrim të përhershëm në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve Rrugore).

5. Ndërkohë, importi në Republikën e Shqipërisë i një automjeti të hershëm, të prodhuar pas vitit 1970, rregullohet nëpërmjet Listës së miratuar të Mjeteve Historike, sipas parashikimeve të Nenit 20 të kësaj Rregulloreje. Përfundimisht me këtë rregull, do të merren në shqyrtim për të fituar statusin Retro ato automjete rrugore të hershme të importuara që zotërojnë një Certifikatë Vjetërsie të vlefshme të një klubi të huaj, apo një kartë identifikimi të lëshuar nga FIVA. Gjithashtu, mjetet *Replica* përjashtohen nga ky kriter, duke qenë se imitojnë mjete të së shkuarës së hershme.

## **Neni 6**

### *Komisioni Retro dhe përbërja e tij*

Komisioni Retro ka si funksion kryesor vlerësimin dhe klasifikimin e mjeteve rrugore të hershme. Ky Komision ka në përbërje:

1. Tre përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;
2. Një përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për transportin;
3. Një përfaqësues nga radhët e Komunitetit Retro.

Kryetari i Komisionit Retro zgjidhet mes anëtarëve të Komisionit. Në rast se anëtarët nuk arrijnë të përzgjedhin një kryetar, zgjedhja e tij do të bëhet përmes shortit.

Për punën e kryer, anëtarët e Komisionit Retro që nuk vijnë nga radhët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, kanë të drejtë të trajtohet me një pagesë të veçantë. Pagesa e tij do të jetë e barabartë me pagën ditore të Përgjegjësit të Sektorit të Regjistrimit të Mjeteve.

## **Neni 7**

### *Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit Retro*

Anëtarët e Komisionit Retro që vijnë nga radhët e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, përzgjidhen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm, duke u mbështetur në aftësitë profesionale, përvojën dhe njohuritë e tyre teknike.

Anëtari i Komisionit Retro që vjen nga komuniteti i mjeteve historike, ka mandat 1 (një) vjeçar. Përzgjedhja e tij do të bëhet në përputhje me kualifikimin dhe njohuritë specifike mbi kategori të caktuara mjetesh historike. Në rast se ka disa propozime, do të përzgjidhet kandidati që ka më shumë kualifikime.

## **Neni 8**

### *Faqja zyrtare*

Çdo njoftim zyrtar, informacion mbi aktivitetet e organizuara nga Retro apo dokument i publikuar nga Qendra Historike Shqiptare Retro bëhet përmes faqes zyrtare [www.retro.al](http://www.retro.al).

## **Neni 9**

### *Shqyrtimi paraprak i kriterëve të pranimit*

Çdo person që zotëron një mjet rrugor që *prima facie* plotëson kriteret e përmendura në Nenin 5 të kësaj Rregulloreje, aplikon për të fituar statusin Retro pranë faqes zyrtare [www.retro.al](http://www.retro.al), duke plotësuar rubrikat përkatëse.

Dosja e aplikimit merret në shqyrtim nga sektori Retro, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Nëse mjeti përmbush të gjitha kriteret e pranimit, të cituara në Nenin 5 të kësaj Rregulloreje, specialisti i sektorit Retro jep aprovimin për vijimin e procedurës së verifikimit brenda 3 (tre) ditësh. Në rast se gjykohet që mjeti nuk i plotëson kushtet për të fituar statusin Retro, specialisti i sektorit Retro kthen një përgjigje të argumentuar për refuzimin, brenda 7 ditësh kalendarike nga data e aplikimit.

Nëse aplikimi bie ndesh me Pikën 5, të Nenit 5, të kësaj Rregulloreje, por ka arsye për të besuar se mjeti mund të mbartë vlera historike, vijohet me procedurën e shqyrtimit, sipas parashikimeve të paragrafit të dytë të Nenit 20. Afati i trajtimit të aplikimit në këto raste është më i gjatë se afati 3 (tre) ditor, i parashikuar në procedurën e zakonshme.

## **Neni 10**

### *Detyrat e specialistit të sektorit Retro*

Detyrat e specialistit të sektorit Retro përfshijnë, ndër të tjera:

1. Shqyrtimin dhe verifikimin e të dhënave të deklaruara nga aplikuesi në sistemin online të [www.retro.al](http://www.retro.al) ;
2. Mbajtjen e korrespondencës me aplikuesin, duke respektuar afatet e parashikuara në këtë Rregullore dhe duke argumentuar ligjërisht çdo përgjigje të kthyer kundrejt tij;
3. Përgatitjen e dosjes së mjetit, për të cilin Komisioni Retro do të kryejë verifikimin fizik;



4. Verifikimin e të dhënave në sistemin *eDPSHTRR*, nëse mjeti ka qenë më parë i regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
5. Në rast të akordimit të statusit Retro, administrimin e dokumentacionit të mjetit dhe hedhjen e të dhënave në regjistrin e Qendrës Historike Shqiptare Retro;
6. Administrimin e dosjeve të mjeteve Retro;
7. Trajton kërkesën e çdo mjeti që nuk është pjesë e Listës së Mjeteve Historike, siç parashikohet në dispozitat e kësaj Rregulloreje (Neni 20).

### **Neni 11**

#### *Procedura për mjetet pa dokumentacion origjine*

Komisioni Retro mund të marrë në shqyrtim një aplikim për një mjet, aplikuesi i të cilit nuk disponon dokumente që provojnë origjinën e mjetit apo të pjesëve që përbëjnë mjetin. Ky aplikim merret në shqyrtim vetëm pasi është plotësuar Formulari i Vetëdeklarimit, nëpërmjet të cilit aplikuesi merr përsipër të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë administrative, penale dhe civile, që vijnë si rrjedhojë e zotërimit të mjetit në kohë. Formulari plotësohet gjatë verifikimit fizik të mjetit, në prani të specialistit të sektorit Retro që ka në shqyrtim aplikimin.

Nëse mjeti plotëson kriteret e pranimit dhe Komisioni konstaton se kushtet teknike për të fituar statusin Retro janë plotësuar, specialisti i sektorit Retro bën verifikimin e të dhënave të mjetit në sistemet elektronike që disponon DPSHTRR dhe në sistemin e Interpol. Mjeti mund të fitojë statusin Retro vetëm nëse nuk konstatohen problematika nga verifikimi i kryer.

### **Neni 12**

#### *Administrimi i dokumentacionit gjatë verifikimit dhe vendimmarrja*

Spektori Retro administron dokumentacionin e mjetit të paraqitur gjatë aplikimit. Komisioni vijon procedurën e vlerësimit, duke bërë verifikimin fizik dhe teknik të mjetit. Në përfundim të procedurës, mjeti fiton statusin Retro, duke u vlerësuar si mjet me rëndësi historike, vetëm nëse vlerësohet si i tillë nga të paktën tre anëtarë të Komisionit Retro.

### **Neni 13**

#### *Kriteret teknike për verifikimin e mjetit*

Pas verifikimit të dokumentacionit dhe aprovimit fillestar nga sektori Retro, dosja i përcillet Komisionit, për vijimin me fazën e verifikimit fizik të mjetit. Komisioni Retro shqyrton kriteret, si më poshtë vijon:

#### **1. IDENTIFIKIMI I TREGUESVE TEKNIK TË MJETIT**

- 1.1. Marka/Prodhuesi;
- 1.2. Modeli;
- 1.3. Numri i shasisë;
- 1.4. Viti i prodhimit;
- 1.5. Targa;
- 1.6. Pronari/Zotëruesi.

Është detyrim i pronarit të mjetit të mirëmbajë vendin ku është stampuar numri i shasisë (*pika 1.3*). *Mungesa e numrit të shasisë e bën të pamundur identifikimin e mjetit dhe, për pasojë, vijimin e procedurës.*

Nëse “Viti i prodhimit” (*pika 1.4*) nuk përcaktohet qartë tek treguesit teknik të mjetit apo aktet e tjera provuese:



- a) Për të përcaktuar vitin e prodhimit, mund të shfrytëzohet dokumentacioni i një mjeti të njëjtë me mjetin në shqyrtim;
- b) Në rast se viti i regjistrimit nuk përcaktohet qartë në dokumentacion, apo viti i prodhimit i pretenduar nga zotëruesi i mjetit është të paktën 1 (një) vit më i vonshëm se viti kur është prodhuar modeli i fundit i asaj gjenerate, do të merret ky i fundit si vit i prodhimit të mjetit.

## 2. SHASIA DHE KARROCERIA

- 2.1. Pesha e mjetit në kilogramë;
- 2.2. Ruajtja e strukturës së shasisë dhe kabinës, sipas specifikave të origjinës:
  - 2.2.1. Me platformë;
  - 2.2.2. Tubolare;
  - 2.2.3. Njëpjesëshe e derdhur;
  - 2.2.4. Shasi e zakonshme;
  - 2.2.5. Etj.
- 2.3. Ruajtja e formave të karrocërisë, sipas specifikave të origjinës;
- 2.4. Materiali me të cilin është ndërtuar shasia dhe kabina;
- 2.5. Materiali me të cilin janë ndërtuar panelet e karrocërisë;
- 2.6. Prania e ndryshkut në mjet;
- 2.7. Ngjyra e mjetit;
- 2.8. Sistemi i amortizimit.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse mjeti:

- a) Paraqet ndryshime në strukturën e shasisë dhe/apo të kabinës, apo ndryshime në materialet që janë parashikuar në fabrikim për atë model (*pika 2.2 dhe 2.4*). Aplikimi do të refuzohet edhe nëse mjeti paraqet vetëm modifikime të pjesshme të strukturës origjinale trupore.
- b) Ka ndryshime thelbësore të formave të karrocërisë dhe të materialeve të përdorura për të prodhuar panelet e karrocërisë (*pika 2.3 dhe 2.5*). Për shembull, aplikimi do të refuzohet nëse mjeti në origjinë ka qenë coupé, por paraqitet për shqyrtim si cabriolët.
- c) Ka prani të ndryshkut korroziv në shasi, kabinë dhe panelet e karrocërisë (*pika 2.6*). Riparimi dhe restaurimi duhet të jetë i tillë që të eliminojë ndryshkun korroziv dhe të rikthejë mjetin sa më afër gjendjes fillestare.
- d) Ka aplikuar një bojë që nuk përfshihet në spektrin e ngjyrave të asaj gjenerate, të atij modeli. Nuk është kriter i domosdoshëm ruajtja e ngjyrës origjinale të mjetit, por ngjyra e përdorur gjatë restaurimit duhet patjetër t'i përkasë spektrit të ngjyrave të parashikuara për atë model (*pika 2.7*).
- e) Paraqet modifikime në sistemin e amortizimit. Ky rregull vlen edhe nëse sistemi i përdorur ka qenë i parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate (*pika 2.8*).

## 3. MOTORI DHE KUTIA E SHPEJTËSISË

- 3.1. Ruajtja e njësisë motorike origjinale të mjetit;
- 3.2. Karakteristikat teknike të parashikuara gjatë fabrikimit (cilindrata, fuqia, etj.);
- 3.3. Pjesët përbërëse (pistona, injektorë, turbina, kolektorë, etj.);
- 3.4. Ruajtja e kutisë së shpejtësisë, sipas specifikave të përcaktuara gjatë fabrikimit të atij modeli.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse:



- a) Mjeti nuk përdor njësinë motorike origjinale. Bëjnë përjashtim rastet kur, për shkak të mungesës apo vështirësisë në gjetjen e një apo më shumë pjesëve të këmbimit, bëhet i pamundur restaurimi i motorit origjinal. Në këto raste, ndërrimi i motorit do të pranohet vetëm nëse motori zëvendësues ka qenë i parashikuar për versionin, modelin dhe gjeneratën e mjetit në fjalë (pika 3.1).
- b) Motori ka pësuar modifikime thelbësore, duke përdorur pjesë që nuk janë parashikuar për atë model në periudhën e fabrikimit, me synim ndryshimin e karakteristikave teknike dhe rritjen e performancës së mjetit (pika 3.2 dhe 3.3).
- c) Motori dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale gjatë procesit të verifikimit fizik të mjetit.

#### 4. SISTEMI I NDEZJES

- 4.1. Çelësi i kuadrit;
- 4.2. Lloji i ndezjes së motorit (manivelë, motorino, etj);
- 4.3. Bateria dhe linjat elektrike;
- 4.4. Dinamo (alternatori);
- 4.5. Sistemi i ushqimit me karburant;
- 4.6. Kandelet/kandeletat.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse:

- a) Mjeti nuk përdor sistemin e ndezjes origjinal, apo sistemi është modifikuar/tjetërsuar dhe nuk përputhet me specifikat e parashikuara gjatë fabrikimit. Bëjnë përjashtim rastet kur, për shkak të mungesës apo vështirësisë në gjetjen e një apo më shumë pjesëve të këmbimit, bëhet i pamundur restaurimi i sistemit origjinal. Në këto raste, zëvendësimi i pjesëve përbërëse të sistemit do të pranohet, vetëm nëse pjesët zëvendësuese të përdorura kanë qenë të parashikuara për versione të tjera të asaj gjenerate.
- b) Sistemi i ndezjes dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale gjatë procesit të verifikimit fizik të mjetit.

#### 5. DISKU DHE GOMAT

- 5.1. Lloji i diskut, sipas specifikave të përcaktuara gjatë fabrikimit të mjetit:
  - 5.1.1. Materiali (dru, çelik, alumin, etj.);
  - 5.1.2. Modeli;
  - 5.1.3. Përmasat;
  - 5.1.4. Ngjyra.
- 5.2. Përmasat e gomave.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse:

- a) Disku është zëvendësuar me një model të ndryshëm nga ai i fabrikimit të mjetit. Përjashtohen nga ky rregull rastet kur, për shkak të materialit të diskut (*p.sh. dru*) dhe vjetërsisë së modelit, disku origjinal është i pamundur të restaurohet dhe nuk mund të gjendet një disk zëvendësues i të njëjtit model. Në këto raste do të lejohet përdorimi i një disku zëvendësues, që është përdorur për versione të tjera të atij modeli apo për modele të tjera të asaj marke, me kushtin që rrezja e diskut zëvendësues të jetë maksimalisht 2 (dy) inç më e madhe se rrezja e diskut origjinal.
- b) Disku është ngjyrosur, kur kjo nuk ka qenë e parashikuar në modelin origjinal.





- c) Disku ka dëmtime që ndikojnë në sigurinë dhe qarkullimin normal në rrugë. Ky kusht vlen edhe për gomat e mjetit.
- d) Gjerësia dhe rrezja e gomës nuk përputhen me përmasat e parashikuara në origjinë.
- e) Janë vendosur pjesë shtesë që krijojnë hapësirë ndërmjet diskut të gomës dhe tamburit (*spesor disku*).

## 6. KABINA E MJETIT

- 6.1. Tapiceria;
- 6.2. Ndenjëset;
- 6.3. Kroskoti;
- 6.4. Timoni, leva e marshit, frenat e stacionimit, etj.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse:

- a) Restaurimi i tapicerisë dhe i ndenjësive bëhet duke shpërfillur veçoritë dalluese të brendisë së atij versioni/modeli specifik (*pika 6.1 dhe 6.2*). Këtu përfshihet materiali i përdorur (*p.sh., lëkura në vend të pëllhurës*), forma/ngjyra e tegelave, si dhe çdo element tjetër karakterizues i restaurimit, që e largon brendinë e kabinës nga pamja e saj origjinale.
- b) Timoni, leva e marshit, takimetri, paneli i kontrollit dhe elementë të tjerë të kabinës paraqesin dëmtime dhe/apo elemente korrozioni.
- c) Janë montuar apo përshtatur pajisje, teknologjia e së cilave nuk ka qenë e parashikuar gjatë fabrikimit për mjetin në shqyrtim, apo për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.

## 7. SISTEMI I DREJTIMIT

- 7.1 Krahu i timonit;
- 7.2 Lloji i sistemit të drejtimit.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse:

- a) Mjeti që paraqitet në verifikimin fizik, ka ndryshuar krahun e timonit (*pika 7.1*).
- b) Është ndryshuar lloji i sistemit të drejtimit (*p.sh., nga mekanik në hidraulik*). Përfshihen nga ky rregull rastet kur sistemi i ri i drejtimit mund të gjendej në versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit.
- c) Sistemi i drejtimit dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale gjatë procesit të verifikimit fizik, duke mos garantuar qarkullimin e sigurt të mjetit në rrugë.

## 8. SISTEMI I NDRIÇIMIT

- 8.1 Fenerët;
- 8.2 Indikatorët e drejtimit;
- 8.3 Dritat e pasme.

Përbën shkak refuzimi për aplikimin nëse:

- a) Gjatë procesit të restaurimit, fenerët, indikatorët e drejtimit dhe/apo dritat e pasme kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model.
- b) Sistemi i ndriçimit është pasuruar me elementë që kanë qenë parashikuar për atë model (*p.sh., drita mjegulle shtesë*). Përfshihen ndaj këtij rregulli bëjnë rastet kur ky ndryshim ka qenë i parashikuar për versione specifike të asaj gjenerate të mjetit.





- c) Ndryçimi i mjetit bëhet me llamba apo teknologji që nuk përputhet me specifikat e modelit. Ky rregull vlen edhe në rastet kur në treg ofrohen ndryçues me teknologji të re, që janë fabrikuar posaçërisht për modelin përkatës.
- d) Sistemi i ndryçimit dhe pjesët e tij përbërëse janë jo-funksionale gjatë procesit të verifikimit fizik, duke mos garantuar qarkullimin e sigurt të mjetit në rrugë.

## 9. SISTEMI I SHIKIMIT PRAPA

- 9.1 Modeli dhe numri i pasqyrave;
- 9.2 Koha e fabrikimit;
- 9.3 Pozicioni.

Përbën shkak për refuzimin e aplikimit nëse:

- a) Gjatë procesit të restaurimit, pasqyrat kanë pësuar ndryshime që nuk kanë qenë të parashikuara gjatë fabrikimit për atë model (*p.sh., lysterja e kapakut të pasqyrës, kur në origjinë ka qenë i kromuar*).
- b) Pasqyra është zëvendësuar me një model tjetër. Bëjnë përjashtim ndaj këtij rregulli rastet kur pasqyra zëvendësuese ka qenë e parashikuar për versione të tjera të asaj gjenerate të mjetit. Për rastet kur pasqyra zëvendësuese e të njëjtit model nuk mund të gjendet për shkak të vjetërsisë, do të lejohet përdorimi i një pasqyre të prodhuar për modele të së njëjtës periudhë kohore.
- c) Numri i pasqyrave të jashtme të mjetit ka ndryshuar nga specifikat e origjinës.
- d) Pozicioni i pasqyrave të jashtme ka ndryshuar.

### Neni 15

#### *Klasifikimi i mjeteve historike*

Gjatë verifikimit, Komisioni Retro bën gjithashtu vlerësimin dhe klasifikimin e mjetit sipas:

- 1. Vjetërsisë;
- 2. Karakteristikave teknike;
- 3. Ruajtjes së formës.

Duke u mbështetur në verifikimin e mjetit, Komisioni Retro cakton një kod klasifikues për secilin mjet që fiton statusin Retro, sipas udhëzimeve të Vendimit nr. 880, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave (*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*).

Në përfundim të procesit, të dhënat e nxjerra gjatë procesit të verifikimit, hidhen në sistemin eDPSHTRR nga specialisti i sektorit Retro që ka trajtuar aplikimin.

### Neni 16

#### *Mospërputhja e të dhënave të pronësisë apo e karakteristikave konstruktive*

Nëse konstatohet se ka mospërputhje në të dhënat e pronësisë (zotëruesi i mjetit në sistemin eDPSHTRR rezulton të jetë i ndryshëm nga aplikuesi), bëhet refuzimi i aplikimit me arsyetimin përkatës. Shqyrtimi i mëtejshëm i aplikimit mund të vijojë vetëm nëse aplikuesi paraqet një dokument të vlefshëm, që provon kalimin e të drejtës së pronësisë nga pronari apo trashëgimtarët e pronarit drejt tij, në një nga format e parashikuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.



Gjithashtu, cilido që konstaton se ka mospërputhje ndërmjet dokumentacionit të mjetit dhe karakteristikave konstruktive të verifikuara gjatë kontrollit fizik, të cilat mund të kenë sjellë një abuzim me pagesën e taksave të qarkullimit të mjetit ndër vite, është i detyruar të raportojë këtë fakt pranë Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve dhe Drejtorisë së Auditimit. Procedura e vlerësimit pezullohet dhe vijohet me dërgimin e një memo në drejtoritë e sipërpërmendura, duke parashtruar problematikën e konstatuar. Në rast se konstatimi bëhet nga Komisioni Retro, plotësohet formulari R02 dhe i dërgohet specialistit që trajton aplikimin, për të vijuar me procedurën sipas këtij Neni.

### **Neni 17**

#### *Verifikimi dhe shlyerja e detyrimeve*

Përpara se mjeti të marrë statusin Retro, bëhet verifikimi për detyrime të papaguara. Pasi verifikohet se mjeti nuk ka detyrime, bëhet miratimi i aplikimit dhe lëshohet Certifikata e Njohjes, e cila ka një afat vlefshmërie prej 4 (katër) vitesh.

Në rast se mjeti ka detyrime të papaguara, procedura do të pezullohet. Aplikuesi duhet të paguajë detyrimet e prapambetura, për të vijuar me procedurën dhe për të përfutur Certifikatën e Njohjes.

### **Neni 18**

#### *Certifikata e Njohjes*

Certifikata e Njohjes përmban një përshkrim të detajuar të identitetit të mjetit, si më poshtë vijon:

1. Marka, modeli dhe tipi;
  - a) Mjetet e regjistruara sipas Nenit 5, Pika 1, Shkronja a), të kësaj Rregulloreje, do të evidentohen nëpërmjet emërtimit (*Replica*).
2. Qyteti dhe shteti ku është prodhuar mjeti (nëse njihet ky informacion);
3. Targa e mjetit;
4. Numri i shasisë;
5. Viti i prodhimit;
  - a) Për mjetet *Replica*, nuk do të shënohet viti i modelit të imituar, por viti i montimit efektiv të mjetit.
6. Të dhënat teknike (vëllimi i motorit, numri i cilindrave, përmasat e mjetit, etj.)
7. Gjeneralitetet e zotëruesit të mjetit Retro;
8. Kodi i kategorizimit të mjetit, sipas shtojcës XII, të VKM Nr.153, dt. 07.04.2000 (kodet e kategorizimit sipas standardit të FIVA);
9. Periudha e vlefshmërisë së Certifikatës së Njohjes;
10. Numri i serisë së Certifikatës.

Kjo Certifikatë nënshkruhet nga kryetari i Komisionit Retro ose, në mungesë të tij, nga një prej anëtarëve të Komisionit Retro. Me lëshimin e Certifikatës, vijohet menjëherë me transferimin e të dhënave dhe regjistrimin e mjetit në listën e Qendrës Historike Shqiptare Retro.

### **Neni 19**

#### *Publikimi në Qendrën Historike Shqiptare Retro*

Në listën e Qendrës Historike Shqiptare Retro, krahas të dhënave të marra nga sistemi *eDPSHTRR*, do të shtohen:

1. Numri serial i regjistrit në fjalë;
2. Afatet e vlefshmërisë së Certifikatës së Njohjes;

3. Kategorizimi i mjetit sipas kodeve përkatëse;
4. Gjeneralitetet e zotëruesit të mjetit Retro;
5. 5 (pesë) pamje të mjetit (një fotografi ballore, dy anësore, një fotografi e pasme dhe një brenda kabinës).

## **Neni 20**

### *Lista e Mjeteve Historike*

Me qëllim rritjen e cilësisë së automjeteve të hershme që importohen në Republikën e Shqipërisë dhe rritjen e efikasitetit në administrimin e aplikimeve, miratohet një listë me markat, modelet dhe versionet e automjeteve që konsiderohen se mbartin vlera historike. Sektori Retro mbështetet në këtë listë për vendimmarrjet përkatëse.

Për ato automjete që nuk janë përfshirë në Listën e Mjeteve Historike, por ka arsye për të besuar se mund të mbartin vlera historike, mund të paraqitet një kërkesë me shkrim për përfshirjen e modelit në fjalë në Listën e Mjeteve Historike, duke argumentuar kërkesën dhe duke përfshirë gjithë dokumentacionin mbështetës. Prioritet do të kenë automjetet:

- a) lindore (të prodhuara në vendet e ish Bashkimit Sovjetik, Kinë, apo vende të tjera të bllokut lindor);
- b) që janë përdorur në një eveniment/aktivitet që shënon një ngjarje jubilarë në histori;
- c) që janë përdorur nga një personalitet që ka lënë gjurmë në histori, brenda ose jashtë vendit;
- d) që janë përdorur në një ngjarje historike ose identifikohen me një vepër arti, produkt, apo situatë me vlera historike/kombëtare dhe me rëndësi për kultura specifike.

Lista e Mjeteve Historike përditësohet në mënyrë periodike dhe publikohet në faqen zyrtare [www.retro.al](http://www.retro.al).

## **Neni 21**

### *Lista "Future Classics"*

Ka shumë mjete që mund të ruhen, blihen ose importohen për qëllime koleksionimi dhe për pasurimin e motorizimit kombëtar, të cilat ende nuk e kanë arritur vjetërsinë e duhur për t'u përfshirë në Regjistrin e Mjeteve Retro. Për të dalluar qartë mjetet e vjetra nga mjetet e hershme me interes historik, është hartuar Lista e Mjeteve me Interes Historik, ose ndryshe "Future Classics". Kjo listë përfshin modele me vjetërsi prej të paktën 20 vitesh. Ajo do të shërbejë si një udhëzues për importin e modeleve që paraqesin vlera potenciale historike, por ende nuk e kanë arritur vjetërsinë për të vijuar me procesin e përfshirjes në Regjistrin e Mjeteve Historike Retro. Procesi i verifikimit për marrjen e statusit Retro do të vijojë vetëm kur mjeti të plotësojë vjetërsinë e domosdoshme (30 vite). Prania në këtë listë do të jetë kriter i detyrueshëm për vijimin e procesit të importit.

Lista "Future Classics" përditësohet në mënyrë periodike dhe publikohet në faqen zyrtare [www.retro.al](http://www.retro.al).

## **Neni 22**

### *Mjetet në zotërim të institucioneve publike apo që administrohen nga Shteti*

Në zbatim të pikës 12 të Nenit 211/a, të Vendimit nr.153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave dhe të shkronjës "a", të Nenit 5, të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008, institucionet

shtetërore që kanë në inventarin e tyre një mjet rrugor të prodhuar të paktën 30 (tridhjetë) vite më parë, ia përcjellin këtë mjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të verifikuar nëse mjeti përmbush kriteret historike për të fituar statusin Retro.

Spektori Retro bën vlerësimin paraprak të dokumentacionit të përcjellë nga ana e institucionit shtetëror. Nëse mjeti nuk plotëson kriteret e nevojshme për t'u konsideruar mjet me rëndësi historike, lejon vijimin e procedurës së shitjes apo nxjerrjes jashtë përdorimit. Nëse mjeti plotëson kriteret për t'u konsideruar mjet me rëndësi historike, vijohet me procedurën e vlerësimit nga Komisioni Retro.

Nëse Komisioni Retro konstaton se mjeti rrugor përmbush kushtet teknike për të fituar statusin Retro, mjeti do të kalojë në administrimin e DPSHTRR, ose do të ndërmerren veprimet e nevojshme administrative për ruajtjen e tij. Në rast se Komisioni Retro vlerëson se mjeti nuk përmbush kushtet për të fituar statusin Retro, sektori Retro lëshon autorizimin për të lejuar institucionin që zotëron mjetin të vijojë me shitjen apo nxjerrjen e tij jashtë përdorimit.

### **Neni 23**

#### *Importi me qëllim përfshirjen në Retro*

Të gjithë ata që synojnë të importojnë një mjet, me qëllim përfshirjen në listën e Qendrës Historike Shqiptare Retro, duhet të marrin një aprovim paraprak për lejimin e importit të mjetit në fjalë. Sektori Retro merr në shqyrtim kërkesën e sjellë nga autoriteti doganor përkatës përmes adresës zyrtare të e-mail. Kërkesa do të merret në shqyrtim vetëm për mjetet që:

1. Nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në Vendimin nr. 633, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave;
2. Janë prodhuar pas 31 Dhjetorit 1970;
3. Janë të destinuara të përfshihen në Retro.

Nëse mjeti plotëson kriteret e pranimit të cituara në Nenin 5, Nenin 20 dhe në Nenin 21 të kësaj Rregulloreje, dërgohet aprovimi pranë autoritetit doganor përkatës, për lejimin e hyrjes në territorin doganor shqiptar. Në të kundërt, përcillet përgjigja negative, duke mos lejuar importin e mjetit.

### **Neni 24**

#### *Targa Retro*

Mjeti Retro pajiset me targa që plotësojnë standardet teknike, të parashikuara në Vendimin nr.153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores në zbatim të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë". Targat Retro janë dy llojesh:

1. Targë Retro për Mjet;
2. Targë Retro për Koleksion.

Targa Retro për Koleksion është targë me karakteristika të ndryshme nga targa Retro për Mjet (sfondi dhe karakteret). Kjo targë mund të kërkohet vetëm nga persona që kanë një koleksion me të paktën tre mjete të pajisura me Certifikatë Njohje të vlefshme. Targa Retro për Koleksion mund të mbartet nga një mjet në tjetrin, me kushtin që mjetet t'i përkasin të njëjtit klasifikim mjeti rrugor.

Në rast se mjeti Retro ka targa që i përkasin kohës së regjistrimit të parë, apo targa të prodhuara përpara datës 01.09.2010, zotëruesi i mjetit do të ketë mundësi t'i ruajë këto targa për qëllim koleksioni apo si suvenir. Këto targa nuk do të mund të përdoren më për qarkullim, përveç



rasteve kur mjeti merr pjesë në parada dhe lëviz në karvan me mjete të tjera historike. Në të tilla raste targa Retro duhet të jetë gjithmonë e dukshme në mjet. Pas marrjes së statusit Retro, vijohet me prodhimin e targës, sipas të dhënave të konfirmuara nga Komisioni Retro.

Mjetet që fitojnë statusin Retro në bazë të parashikimeve të pikës 8, të Nenit 211/a, të Vendimit nr.153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, nuk do të kenë mundësi të përfshihen në një moment të dytë në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, duke u pajisur me targë të zakonshme për qarkullim të përditshëm.

## **Neni 25**

### *Autorizimi për qarkullim*

Mjetet Retro mund të qarkullojnë vetëm pasi të jenë pajisur me Autorizimin për qarkullim, të lëshuar nga sektori Retro. Autorizimi ka vlefshmëri maksimale prej 30 ditësh; brenda 1 viti kalendarik mund të merren deri në 3 Autorizime për qarkullim, për një total prej 90 ditësh.

Përzjashtimisht me këtë rregull, anëtarët e shoqatave të themeluara, regjistruara dhe organizuara sipas parashikimeve të Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar dhe Ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001, “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, autorizohen të qarkullojnë për një afat maksimal prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh përgjatë një viti, vetëm pas nënshkrimit të një marrëveshjeje mes shoqatës ku janë anëtarë dhe DPSHTRR-së. Kushtet dhe modalitetet përcaktohen në marrëveshjen e miratuar.

Zotëruesi i mjetit Retro mund të aplikojë për t’u pajisur me Autorizim online. Pas aplikimit dhe kryerjes së pagesës, lëshohet Autorizimi në format elektronik. Zotëruesi i mjetit mund të aplikojë gjithashtu në sportelin e Drejtorisë Rajonale ku ka vendbanimin, ku do të pajiset me një Autorizim të stampuar, në formën e Librit të Lëvizjes. Për çdo udhëtim, duhet evidentuar në Librin e Lëvizjes data e nisjes dhe e mbërritjes, itinerari i lëvizjes dhe arsyeja e udhëtimit. Nëse aplikanti kërkon të qarkullojë me më shumë sesa një mjet, ai duhet të pajiset me Autorizim edhe për mjetet e tjera.

Autorizimi elektronik për qarkullim dhe Libri i Lëvizjes janë subjekt kontrolli nga Policia e Shtetit. Së bashku me Certifikatën e Njohjes, duhet të shoqërojnë mjetin në çdo udhëtim. Mungesa e tyre shoqërohet me masa administrative.

## **Neni 26**

### *Të drejtat që burojnë nga zotërimi i një mjeti Retro*

Të gjithë subjektet që zotërojnë një mjet Retro, gëzojnë të drejtat që i garanton Ligji dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje. Ndër këto, theksojmë:

1. Të drejtën për të marrë pjesë në parada, organizime, panaire, shfaqje, ture automobilistike, etj. Përfshirja në Retro nuk i pengon këto subjekte të marrin pjesë në aktivitete të tjera, që nuk janë organizuar apo mbështetur nga Retro;
2. Të drejtën për t’u anëtarësuar në shoqata vendase apo të huaja, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre ruajtjen, koleksionimin dhe shfaqjen e mjeteve rrugore të hershme;
3. Të drejtën të shfaqin mjetet e tyre në muzetë publike apo private, si dhe të shfaqin mjetin e tyre për publikun edhe në rrugëtime individuale.
4. Në rast se nuk kanë mundësi të sigurojnë ruajtjen e mjetit të tyre, kanë të drejtë të kërkojnë ruajtjen e përkohshme pranë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Marrëveshja përkatëse do të rregullohet sipas një



formati standard, të miratuar nga DPSHTRR, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil dhe legjislacionit në tërësi;

### **Neni 27**

#### *Detyrimet që sjell zotërimi i një mjeti Retro*

Të gjithë subjektet që zotërojnë një mjet Retro duhet të përmbushin detyrimet e parashikuara në Ligj dhe në dispozitat e kësaj Rregulloreje. Ndër këto theksojmë:

1. Të ruajnë me mirëbesim mjetet rrugore të hershme, me interes historik dhe koleksionimi, si dhe të përmbushin detyrimet procedurale, duke siguruar akses për DPSHTRR-në në ushtrimin e kompetencave të saj ligjore;
2. Të informojnë DPSHTRR-në për çdo rast dëmtimi, zhvlerësimi apo vjedhje të mjetit Retro, krahas dërgimit të njoftimit tek organet e tjera ligj-zbatuese;
3. Të respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor gjatë udhëtimit me mjetin Retro, si dhe të gjithë detyrimet e tjera të parashikuara në Kodin Rrugor dhe Vendimin nr.153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave.
4. Të respektojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë Rregullore.

### **Neni 28**

#### *Promovimi i trashëgimisë motorike*

Me qëllim promovimin e historisë së motorizimit dhe nxitjen e kulturës së lidhur me mjetet historike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka të drejtë të organizojë aktivitete kulturore, shfaqje, evenimente, të blejë mjete që mbartin vlera historike, të mbrojë trashëgiminë kulturore përmes restaurimit të mjeteve rrugore të hershme, si dhe të nxisë zhvillimin e këtij sektori përmes programeve formuese profesionale.

### **Neni 29**

#### *Shërbime dhe tarifa*

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:

1. Pajisjen me Targë Retro për Koleksion;
2. Pajisjen me Targë Retro për Mjet;
3. Lëshimin e Certifikatës së Njohjes;
4. Lëshimin e dublikatit të Certifikatës së Njohjes, për rastet e humbjes, vjedhjes, apo shkatërrimit;
5. Përditësimin e Certifikatës së Njohjes në rast shitje, dhurimi, apo çdo mënyre tjetër ndryshimi pronësie të parashikuar nga ligji;
6. Lëshimin e Autorizimit të Lëvizjes;
7. Procedurën e verifikimit dhe klasifikimit si mjet rrugor i hershëm;
8. Humbje, vjedhje, shkatërim targe;
9. Riprodhim targe për dëmtim të saj;
10. Humbje, vjedhje, shkatërim të certifikatës së njohjes;
11. Dëmtim i certifikatës së njohjes;
12. Skadimi i afatit të vlefshmërisë së certifikatës së njohjes;
13. Humbje, vjedhje, shkatërim të librit të udhëtimit;
14. Dëmtim ose humbje vlefshmërie e librit të udhëtimit certifikatës së njohjes;
15. Ndryshimi i pronësisë së mjetit retro, për pajisje me certifikatë njohje të përditësuar;
16. Ndryshimi i pronësisë së mjetit retro, për pajisje me certifikatë njohje të re;





17. Çregjistrim i mjetit retro për eksport;
18. Rikthim në mjet retro pas çregjistrimit për eksport;
19. Çregjistrim i përhershëm, për jashtë përdorimi, i mjetit retro;
20. Çregjistrim i përhershëm i mjetit retro për rifutjen në qarkullim në sistemin edpshttr;
21. Çregjistrim i përkohshëm i mjetit retro;
22. Ndryshim vendbanimi;
23. Ndryshim gjeneralitetesh;
24. Pajisje me leje qarkullimi ndërkombëtare;
25. Regjistrim targë retro për koleksion;
26. Shtim mjeti në listën e targës retro për koleksion;
27. Heqje mjeti nga lista e targës retro për koleksion (kur lista përmban më shumë se 3 mjete);
28. Humbje, vjedhje, shkatërim targë retro për koleksion;
29. Riprodhim targë retro për koleksion, për dëmtim të saj.

Shërbimet e sipërpërmendura do të ofrohen përkundrejt pagesës së tarifave të miratuara. Për rastet që nuk janë parashikuar në këtë Rregullore, aplikohen të njëjtat tarifa shërbimi sikurse për shërbimet e mjeteve rrugore të zakonshme, që janë të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Mjeteve.

### **Neni 30**

#### *Shërbimi në sportelet e Drejtorive Rajonale*

Për rastet e humbjes, vjedhjes apo shkatërrimit të targës Retro, zbatohet e njëjta procedurë sikurse ndodh me një targë të zakonshme, që përdoret për qarkullim të përditshëm. Zotëruesi i mjetit Retro bën aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale ku ka vendbanimin.

Për rastet e humbjes, vjedhjes apo dëmtimit të Certifikatës së Njohjes, zotëruesi i saj njofton sektorin Retro në DPSHTRR. Specialisti i këtij sektori vijon me plotësimin e dokumentacionit dhe lëshimin e dublikatit me afatin e vlefshmërisë së mbetur. Çdo shërbim tjetër dhe procedura përkatëse për një mjet Retro, do të jetë e njëjtë me atë të mjeteve të regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve.

Në rastin kur mjeti Retro shitet, dhurohet, apo ndërron pronësi me ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar nga Ligji, bëhet azhurnimi i Certifikatës së Njohjes, pa iu nënshtuar sërish procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të mjetit. Certifikata lëshohet me afatin e vlefshmërisë së mbetur, por me emrin e pronarit të ri. Nëse pronari i ri i mjetit Retro dëshiron të pajiset me Certifikatë me afat vlefshmërie të plotë, duhet t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të mjetit, sikurse çdo mjet tjetër.

### **Neni 31**

#### *Hartimi i normës juridike për plotësimin e kuadrit ligjor*

Kur, nga rrethanat faktike, konstatohet se kuadri ligjor për mjetet rrugore historike nuk është i shprehur qartë, Drejtori i Përgjithshëm nxjerr urdhra në mbështetje dhe në interpretim të Kodit Rrugor, Vendimit nr. 153, datë 07.04.2000, të Këshillit të Ministrave dhe akteve të tjera nënligjore, me qëllim plotësimin, saktësimin apo interpretimin më të mirë të kuadrit ligjor të sipërpërmendur.

### **Neni 32**

#### *Detyrime të përgjithshme*





Në zbatimin e kësaj Rregulloreje mbahet parasysh se:

1. Komisioni Retro është i detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e parashikuara më sipër;
2. Administrata e DPSHTRR dhe e DRSHTRR-ve janë të detyruara të njohin dhe zbatojnë dispozitat e përfshira në këtë Rregullore;
3. Shkelja e dispozitave të kësaj Rregulloreje përbën shkak për marrjen e masave disiplinore përkatëse, sipas dispozitave ligjore të parashikuara në aktet normative në fuqi;
4. Mosnjohja e Rregullores nuk e justifikon njohësin apo zbatuesin e saj nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura;
5. Për kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë që nuk përfshihen në këtë Rregullore, zbatohen aktet e tjera normative që rregullojnë fushën e zbatimit të marrëdhënieve që nuk i përmban kjo Rregullore;
6. Çdo akt rregullator i DPSHTRR që bie ndesh me këtë rregullore, qoftë ky në formën e urdhrin apo procedurës së brendshme, shfuqizohet menjëherë.

Kjo rregullore është miratuar me Urdhrin nr. 58, datë 11.01.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe hyn në fuqi menjëherë, duke shfuqizuar Urdhrin nr. 928, datë 29.09.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

